

BLIOTEKA

91-983-1

16

ANDON

ZAKO

ÇAJUPI

37635





ANDON ZAKO ÇAJUPI

ka shkruar nja dy tregime frëngjisht. Veprimtarinë letrare në gjuhën amtare duket se e nisi në vjetët e fundit të shekullit të kaluar, afërsisht nga viti 1898. Nxitje për këtë veprimtari ka qenë edhe takimi i tij me Naim Frashërin, të cilin, siç dihet Çajupi e nderonte shumë dhe e mbante apostull të atdhetarizmit dhe vjershëtor të madh, siç e mbanin të gjithë shqiptarët patriotë.

Më 1902 doli në dritë përmbledhja e parë poetike e Çajupit: «Baba Tomorri», që u prit me entuzjazëm dhe ndikoi, jo vetëm në zhvillimin e mëtejshëm të letërsisë kombëtare, por edhe në zgjimin dhe forcimin e ndërgjegjes patriotike të shqiptarëve.

Në një letër që i dërgon Asdrenit ai njofton se do të botojë së shpejti përmbledhjen e dytë poetike me titull «Dhjata e vjetër», gjë që nuk u bë n'atë kohë dhe që edhe sot e kësaj dite nuk është bërë, megjithëse dorëshkrimi ndodhet në arshivin e shtetit të R.P.SH. Në këtë përmbledhje poetike Çajupi, krahas çfrytëzimit të motiveve biblike dhe laicizimit të tyre, ka përfshirë edhe mjaft motive drejtpërdrejtë patriotike, liridashëse, hymnizuese të luftës së popullit tonë, etj.

Më 1909, pas kryengritjes së xhonturqëve dhe qëndrimit oportunist të bejlerëve shqiptarë ndaj tyre, Çajupi shkruan panfletën e famëshme «Klubi i Selanikut», në të cilën zbulon fytyrën tradhëtare të krerëve turkofilë dhe satirizon demagogjinë e tyre djallëzore dhe të trashë.

Për kohën e luftës së parë botërore dhe për ngjarjet e asaj kohe në Shqipëri dihet se Çajupi përgatiti përmbledhjen poetike «Këngë dhe vome», po gjer më sot, përveç titullit nuk ka dalë në dritë asgjë prej kësaj vepre. Më 1921 ai boton vëllimin me përktihme e përshtatje prej fabulave të La Fontenit, kurse më 1922 vëllimin «Lulet e Hindit» me përktihme e përshtatje nga poezia sanskrite.

Ndërkaq Çajupi nuk i ndahet lëvizjes patriotike dhe

demokratike të bashkatdhetarëve brënda e jashtë vëndit. Ai është ndër të parët prej patriotëve shqiptarë t'Egjyptit, që i dërgojnë një memorandum Konferencës së Londrës, kurse më 1920-1924 poeti mban anën e lëvizjes demokratike dhe pati guximin të dënojë ashpër e me kohë vendosjen e regjimit monarqik në Shqipëri (1928).

Çajupi është edhe një ndër pionierët e dramaturgjisë shqiptare. Përveç komedisë në vargje «Katërmbëdhjetë vjeç dhëndër» ai ka shkruar tragjedinë «Burri i dheut» (1908) dhe ka përshtatur e shqiptarizuar komedinë me një akt «Pas vdekjes», e cila sikurse pamfleta «Klubi i Selanikut» satirizon bejlerët filoturq. Ndër veprat e panjohura të poetit figurojnë edhe drama «Detyra» së bashku me dy vëllime vjershash e fabulash të përshtatura.

Vepra letrare e Çajupit zë një vënd nderi në historinë e lëvizjes çlirimtare të popullit tonë, si shprehëse e idealeve liridashëse e demokratike të masave punonjëse. Ajo zë vënd me rëndësi në historinë e letërsisë shqipe, si një hap i rëndësishëm drejt realizmit; për karakterin thellësisht popullor, për spontaneitetin poetik dhe për veçoritë e shquara artistike të saj.

Andon Zako-Çajupi vdiq në Heliopol t'Egjyptit më 1930.

MËMËDHEU *)

Mëmëdhe quhetë toka,
ku më ka rënurë koka,
ku kam dashur mëm' e atë,
ku më njeh dhe gur' i thatë,
ku kam pasurë shtëpinë,
ku ka njojtur Perëndinë,
strëgjyshët ku kanë qënë
dhe varret q'i kanë vënë,
ku jam rritur me thërime,
ku kam folur gjuhën time,
ku kam fis e ku kam farë,
ku kam qeshur, ku kam qarë,
ku rroj me gas e me shpresë,
ku kam dëshirë të vdesë.

*) Prej vjershës «Mëmëdhe» deri tek vjersha «Misiri» përfshihen krijime që poeti i ka botuar në vëllimin «Baba Tomorri».

SHQIPËTAR!

Shqipërin' e mori Turku,
i vu zjarr!
Shqipëtar, mos rri po duku,
shqipëtar!

Mjaft punove për të tjerë,
o fatkeq!
Kujto vëndë tek ke lerë
dhe tek heq.

Të ka bërë Perëndia
luftëtar,
si s'të lodhi robëria,
shqipëtar!

Erdhi dita të ngrësh kokë,
të kërkosh
lirinë; bashkë me shokë
të lëftosh!

Mos bëni si kini bërë
gjer më dje,
po të lëftoni të tërë
për Atdhe.

Pësëqint vjet kemi rruar
me pahir,
lidhurë nga këmb' e duar
me zinxhir!...

Muslyman' e të krishterë
jemi keq!
Të ngrihemi që të tërë,
djem e pleq!

Të ngrihemi të dëftojmë
trimëri;
ja të vdesim, ja të rrojmë
për liri!

O moj Shoipëriz' e dashur,
Mëmëdhe,
të shoh' me buzë të plasur,
si më sheh.

U shkretove anëmbanë,
Shqipëri,
se shqiptarëtë s'kanë
dashuri.

Gjithë djemtë që ke qarë
dhe mban zi,
për Morenë janë vrarë,
për Turqi!

Çvish rrobat e robërisë,
mëmëdhe,
vish armët e Trimërisë
se ke ne!

SULLTANI

Jam Sulltan, mbret i vërtetë,
shoq të tjerë s'kam në jetë;
gjakëtor e zëmërderr,
nga frika më bëjnë nder!
Dola nga fund' i Azisë
si rrebesh' i Perëndisë:
vrava, preva e shkretova,
botën me gjak e mbulova!
Kur zotova Anadollë,
erdha mora dhe Stambollë,
njerzit i shkova në thikë!
Dhe kush mbeti, rron me frikë!...
Jam i keq si egërsirë!
Të urtët janë të mirë:
dua të quhem i marrë,
po puna të vejë mbarë.
Thera grekër e bullgarë,
thera ermenët e mjerë,
egërsirë si ariu,
me fytyrë si njeriu,
më dërgoi Perëndia
që të vuaj'njerëzia!
Evropa që më shukon,
të më bëjë gjë s'guxon,
se ka mejtime të tjera ...
Prisha, vrava, preva, thera!

Bëra, . . . po ç'nukë kam bërë?
 Prisha botënë të tërë!
 Mysliman' e të krishterë
 kam dërguar n'atë jetë
 më tepër se ç'vdiqnë vetë!
 Jam i zoti, rroj me pallë,
 s'dua të shoh njerz të gjallë!
 Nat' e ditë gjak kërkoj,
 pa pirë gjak s'mund të rroj!
 Dhe tani q'u bëshë plak,
 nukë mund të fryhem gjak!
 Ata që kam nënë zgjedhë,
 me dorë time t'i vrasë,
 të pijë gjakn' e rajasë!
 Pse s'u bë nga Perëndia
 me një kokë njerëzia
 që ta presë menjëherë?
 Të mos mbeteshin të tjerë!
 Të mbetej dheu i shkretë,
 se dojë të rrojë vetë:
 me egërsira të rrojë,
 pa frikë të mbretërojë,
 se më duan e i dua,
 jemi një gjak e një sua!
 S'lashë njeri pa të keq!
 Gra e burra, djem e pleq,
 dridhenë kur më kujtojnë;
 mëmatë më mallëkojnë,
 më mallëkojnë të vatë
 edhe qainë dit' e natë!
 Qajnë! Po kush nukë qa?
 Qajnë burra, qajnë gra,
 qajnë maletë për pyje,
 qajnë fushatë për lule! . . .

Kudo shkela u tha bari!
Ç'la pushka e dogji zjarri! . .
Egërsirë si ariu,
hëngra dhe u' mish njeriu!
Si kam dashur kam punuar,
pse nukë jam i gëzuar?
I lik jam, të liga dua,
nga kush më vjen frikë mua?
Nukë di se ç'kam i ziu,
nga frika gjaku më ngriu...
Me punërat që kam bërë,
më duken armiq të tërë,
mysliman' e të krishtërë;
sa dhe trimat shqipëtarë
zun' e më punojnë varrë!
Humba Moren' e Vllahinë,
Bullgarinë me Sërbinë,
Bosnjënë me Mal' e Zi,
Gjiritnë me Thesali.
Keshë komp'n' e Shqipërisë
direk i gjithë Turqisë;
pse s'më priti sa të vdesë
pa të më dil i pabesë!
Me Shqipëri të lëftonem,
kam frikë mos turpëronem;
kam frikë nga Skënderbeu
mos dalë prapë nga dheu! . .
Se ç'mendoj, a ç'jam i marri!
S'më bën dot gjë shqipëtari.
Dhe sa të jem vet' i gjallë,
nga zgjedha s'ka për të dalë.
Pas meje në këtë jetë,
guri mbi gurë mos mbetë!

PUNËRAT E PERËNDISË

Zot i madh e i vërtetë,
çdo pun' e ke bërë vetë:
bëre qiejtë dhe denë,
bëre yjetë dhe dhenë
bëre diellin me dritë,
bëre nat' e bëre ditë,
bëre erënë dhe retë,
bëre pemëtë me fletë,
bëre hënëzën me yje,
bëre fusha, male, pyje
bëre zoqtë që këndojnë
dhe lulet që lulëzojnë,
bëre dimër' e beharë,
bëre kuaj dhe gomarë,
bëre misrë edhe grurë,
po më shumë bëre gurë.
Si bëre kaqë të mira,
bëre dhe shumë egërsira:
bëre arinë dhe derrë,
bëre ujqër e të tjerë,
bëre... Po ç'nukë ke bërë?
Bëre botënë të tërë.
Bëre dhe djallë me brirë!
Çdo pun' e ke bërë mirë,
po një gjë bëre pa mende
dhe prishe punënë tënde:

kur bëre derr' e arinë,
ç'deshe që bëre Turqinë?
Se të mos qënkej kjo farë,
bota do të vinte mbarë,
dheu do të lulëzonte,
Shqipëria do t'gëzonte.

ATDHEU DHE DASHURIA

Vitua, një pun' e madhe,
 e bukurë si sorkadhe,
 nga gjithë shoqetë çquan
 dhe gjithë trimat e duan.
 Për të tillë bukuri
 kush nukë ka dashuri?
 Një ditë që vij në krua,
 duke ecurë mbi thua,
 poqi një turk trim të marrë.
 Tjetër herë s'e kish parë.
 Robotë që kish i ndrinin
 dhe armët i vetëtinin!
 Kur shtiu syt' e e pa:
 «Vito, të dua! — i tha.
 Vito, do të të marr grua!»
 Vitua u turpërua,
 po më shumë u hidhërua
 dhe ju përgjegj: «S'je për mua,
 se u' një tjetërë dua,
 jemi një bes' e një sua.
 Po merre fjalënë prapë
 dhe shko këtejë me vrapë!
 — Kush është më trim se mua,
 që do të të marrë grua?
 — Ai që jam vluarë
 dhe për të martuarë;

është trim sa s'gjendetë,
 i mirë sa s'bënetë;
 ish vet' i tretë vëlla;
 kush ka qënë si ata?
 Trima sa s'i zinte plumbi!
 Njëri vdiq, i dyti humbi.
 Jorgjin e la Perëndia
 shpresë për mëmën e tia;
 është i vetëm e jetim,
 i dashur' i shpirtit tim
 dhe nga të tërë më trim;
 përdor pallën e hanxharë,
 është i zoti të më marrë!
 Ndaj, të lutem, mos më nga,
 të mos biesh në hata
 se shejtani punë s'ka!
 Turku me të tilla fjalë,
 qiti të shkretënë pallë!
 Nga inati u verdhua
 dhe thirri posi dragua:
 «N'është m'i zoti nga unë,
 le të më dalë këtunë!
 Në më muntë, besa-besë!
 burri yt po le të jesë;
 n'e dërgofsha n'atë jetë,
 die, do të të marr vetë!»
 Vitua shumë u frikua
 lot' i vininë si krua,
 dhe më shtëpi, duke qarë,
 rëfeu ç'i kishte ngjarë.
 Po Jorgji, kur e dëgjoi,
 veshi armëtë dhe shkoi

~~37635~~

14490

SHITE TË
 SHIPKAS TË

u ngjit malitë përjetë,
 ashtu si ngjitenë retë
 dhe me zë të madh si shkëmbi
 po thërrit sa tundej vëndi:
 «Kush është ai q'u lëvdua
 që do të mundet me mua?»
 Me zë të madh si gjëmimi,
 ju përgjegj ahëre trimi:
 «Unë jam ai që shtie
 dhe plumbi dëm nukë bie;
 u' jam ai që kam vrarë
 bejlerë dhe pashallarë;
 dhe kaurë mijë vetë
 kam dërguar n'atë jetë!
 Dhe do të trëmbem tani
 nga një fusharak si ti?
 Tani do ta shoq dhe vetë
 kush është trim i vërtetë...
 Këto thosh turku dhe vinte.
 Po dhe Jorgua e printe;¹⁾
 hodhi armëtë përdhezë
 dhe zuri të sgjeshë brezë,²⁾
 që kish qepur Vitua vetë,
 si fustan e fermeletë;
 kur e kujtoi, u shëmb;
 mos pandehni se u trëmb;
 bëri kryqn' e fshiu lotë:
 «Jam hazër!» hidhet e thotë,³⁾
 edhe më dorë një thikë
 ju vërsul turkut pa frikë.

1) E priste.

2) Të heqë brezin.

3) Jam gati.

Trimi rrëmbeu hanxharë
dhe po hidhej si i marrë.
Fryri era, nga rrëmbimi
lëshon flokatenë trimi.
Atje ku qe afëruar,
me gjoks hapët leshëtuar,
ju duk, në grykë të ti,
varturë një *hajmali*.
Jorgji, kur pa hajmalinë,
sytë përmbi të i ngrinë.
«Dale, tha, ashtu më rruash,
pa lëftojmë kur të duash!
Po në beson Perëndinë,
kush ta fali hajmalinë?
— Nëna në foshnjëri
ma vari për mbarësi.
Po ç'të duhetë kjo punë?
— Një të tillë kam dhe unë!
Shiko! Mëma ma ka falë
dhe mua, kur jeshë djalë!»
Të dy trimat hapnë gjitë
dhe shikonin hajmalitë
qepur me pë të florinjte:
si njëra, si tjetëra,
të dya të vjetëra;
përbrënda, pshtjellur me kartë,
gjenë nga një kryq të artë!
Mbenë të maniturë
dhe si të goditurë!
Të tillë punë kur panë,
u pushtuanë dhe ranë,
dhe të dy një fjalë thanë:

*

«Të kam vëlla, mor i mjerë!
Nga një bark paskemi lerë!
Jemi një fis e një farë,
Jemi të dy shqipëtarë,
po besa na paska ndarë
sa na bëri për të vrarë!
Sot që dimë vetëhenë,
duhetë të bëjmë benë
të duamë Mëmëdhenë.
Tani të marrëmë malë,
të lëftojmë për lirinë,
të mos kthenemi të gjallë
pa shpëtuar Shqipërinë!
Tani Viton ta harrojmë,
me Turqinë të lëftojmë,
ta dërgojmë nga ka ardhë,
të shohmë ditë të bardhë.»

FSHATI IM

Maletë me gurë,
fusha me bar shumë,
aratë me grurë,
më tutje një lumë.

Fshati për karshi
me kish' e me varre
rrotull ca shtëpi
të vogëla fare.

Ujëtë të ftohtë,
era pun' e madhe,
bilbili ia thotë,
gratë si sorkadhe.

Burrat nënë hie
lozin, kuvëndojnë; —
pika që s'u bije,
se nga gratë rrojnë!

Gratë venë nd'arë
dhe në vreshta gratë,

gruaja korr barë,
punon dit' e natë.

Gratë në të shirë,
në të vjela gratë,
ikinë pa gdhirë,
kthenenë me natë.

Gruaja për burrë
digjetë në diell,
punon e s'rri kurrë
as ditën e diel.

O moj Shqipëtarë,
që vet' e nget qetë,
edhe drek' e darkë
kthenej e bën vetë;

moj e mjera grua,
ç'e do burrë zinë
që ftohet në krua
dhe ti mban shtëpinë!

DASHURIA

A

Do të lëvdoj Dashurinë
barabar me Perëndinë,
se Dashuri e vërtetë
na mban të gjallë për jetë.

S'e kam parë Perëndinë,
shoh ngaherë Dashurinë;
Dashuria mbretëron,
se njeriu pa të s'rron.

Cinë të besoj taninë: 1)
Perëndin' a Dashurinë?
Perëndi në këtë jetë
është Dashuria vetë.

B

Si për burra dhe për gra,
dashuria, djalëria,

1) Cilën.

janë si motr' e vëlla,
s'i ndan dot as Perëndia.

I riu me dashuri
rron e gëzon këtë jetë,
dhe pastaj në pleqëri
i rëndonet jet' e shkretë.

Djalëria qëndron pak,
kshtu ka thënë Perëndia;
kur bënet njeriu plak
s'i ka hie dashuria.

O ju të ra e të ri,
do t'u shkojë djalëria,
dhe bashkë me dialëri
fluturon dhe dashuria.

C

Kur jeshmë të vegjëj, si moll' e pabërë,²⁾
putheshim ngaherë ditënë të tërë;
vii e të kërkojë, vii e të thërresë,³⁾
loznim të dy bashkë, rronim me një shpresë.
Mba mënd sa të desha, mba mënd sa më deshe?

2) Kur ishim të vegjël.

3) Të kërkoja... të thërrisja.

Mba mënd si më thoshe e vogël kur jeshë?
 Tani që jam burrë, tani q'u madhove,
 dashurin' e parë pse vall' e harrove?
 Tani q'u poq molla, e hanë të tjerë,
 mikn' e djalërisë s'e qas as në derë!
 Po, si ndjellëndushja vete në vënd tjetër 4)
 dhe kthenetë prapë në fole të vjetër,
 ashtu zëmra jote mundet të kujtojë
 mikn' e djalërisë dhe prapë ta dojë.

D

Handwritten notes in blue ink:
 Mësojta
 t'atë ditë
 që do të
 mësojta

Digjëm, përvëltonem
se të dua shumë;
ditënë mendonem,
natën rri pa gjumë.

Luletë të dinin,
 mike, sa të dua,
 këtu do të vinin
 të qajnë me mua.

Zoqtë të dëgjonin,
 do t'më rrinin pranë
 dhe do të këndonin
 të harrojë sevdanë.

4) Dallëndyshja.

Asnjeri në jetë
 plagën s'ma shëron,
 përveç mikja vetë,
 që vjen e lëndon!

E

Bukuria jote, leshërat e tua
 posi pëndë korbi, të gjata mbi thua,
 ballëtë si diell, faqetë si mollë,
 qafa jot' e gjatë, mesi yt i hollë,
 sisëtë si shegë, dhëmbët si thëlpënjë,
 buzët si burbuqe, sytë si gështënjë,
 dora si dëborë, fjala jote mjaltë,
 kurmi yt i derdhur, shtati yt i naltë. —
 gjithë më kënaqin, të tëra t'i dua,
 po zëmëra jote u bë gur për mual

F

E mba mënd, moj Marë,
 dashurin' e parë?
 Njeri nuk e gjegji,
 se jeshmë të vegji.

Unë pa ty s'rrojë,
 vij' e të kërkojë;
 ti pa mua s'rroje,
 vij' e më kërkoje.

Në lule me erë
putheshim ngaherë,
dhe si burr' e grua
loznim nënë ftua.

Një ditë, të dyza
loznim *mbylla-syza*:
u fshehëm pa dukur
në ferra, në gurë,
u fshehëm kaqë bukur,
sa s'u gjëndm' dot kurrë. . .

G

O moj lulja manushaqe,
dëgjo dashurinë ç'thotë:
të lozëm faqe për faqe,
të na përzihenë lotë.

Ma do zëmra, ma ka ënda
të lozëm ballë për ballë,
se zjarri oë kemi brënda
na djek sikur të mos dalë.

Të lozëm gushë për gushë,
bashkë të vemi, të vimë,
posi shqerratë në fushë,
se të ri gjithënjë s'rrimë.

H

Kam dashurë lulet, konxhen, trëndafilë,
zoqtë që këndojnë, thëlëzat, bilbilë,
tani s'më pëlqejnë, më lënë të ftohtë,
se dua një çupë si hënëz e plotë,
s'ka shoqe në botë.

Kjo është për mua lule trëndafili,
konxhe, manushaqe, thëlëza, bilbili.
Kur më shkon në rugë, me lule në dorë,
leshtrat prapa krahve hedhur si kurorë,
e bardhë si borë,

më mirrenë mëndë, nga sytë verbonem
dhe nga dashuria digjem, përvëllohem,
si digjen në zëmër gjithë sa e njonë,
mahnitën të tërë trimat kur e shonë,
mashalla! i thonë.

I

Pika-pika bie shiu
dhe dëbora flokë-flokë,
vetëtin e fryn veriu,
breshëri kërcet mbi tokë!

Le të frvjë er' e ftohtë,
s'ka ç'më bën dimëri mua:

dashuria më mban ngrohtë,
se pushtoj atë që dua.

Kur fryn era me tallaz,
kur bie dëbor' e shi,
sa flë njeriu me gaz
kur ka mikenë në gji.

VAJE

I

Që ditën që vdiqe, që kur s'të kam parë,
lotë që kam derdhur s'më janë dhe tharë!
Shumë vjet u bënë, sot u mbushnë dhjetë,
që kur më ke lënë dhe s'të shoh ndë jetë!
Ndë ç'kopshte me lule ke qëndruar vallë?
S'të vjen keq për mua? S'të vjen mall për djalë?
O ëngjëll i bukur, mos mëno në botë, 1)
kthehu të të shohmë, të na mbeten lotë.
S'rrojmë dot pa tynë, ti si rron pa neve?
Motëmot që rrojtim bashkë, s'më urreve.
Atje tek rri janë qipariz' e varre...
Ktheu të të shomë, mos na le për fare!
Mos na le të gjorë, me zemër të ngrirë,
kthehu të gëzonesth kur të shoq të birë:
e ke lënë foshnjë, tani u bë burrë,
s'arrite ta rritje, s'të ka parë kurrë!
Për ty shumë herë çoç do të më thotë, 2)
po s'mund t'i përgjigjem se më mbytin lotë!
Kthej kokën mënjanë dhe vështroj përpjetë,
duke psherëtitur te Zot'i vërtetë.

1) Mos u vono.

2) Diçka do të më thotë.

O Zot i vërtetë, s't'erdhi keq për djalë,
 kur i more mëmën dhe më le të gjallë?
 Të më keshe marrë do të qe më mirë
 dhe të rronte mëma të rrite të birë.
 Me se rrojnë foshnjat? Ç'i rrit çilimitë?
 Dashuria e mëmës dhe përkëdhelitë.
 O Zot, të jam falë, mos më le të mjerë,
 dërgom' Evgjeninë ta shoh dhe një herë!
 «Pse s'kuvëndon mirë, more punëbardhë,
 cili vdiq nië herë dhe prapë ka ardhë?
 Gjith' humbasën gruan, mëmën a babanë,
 po ata që mbetën si ti nukë qanë:
 të vdekurin lotë s'e bien në jetë,
 po lutu dhe falu të rriç djalin vetë.»
 Doje drit' o Qiell, more dritën time
 dhe më mbushe jetën plot me hidhërime!
 Tani rroj pa shpresë, ndai s'dua të rroj,
 se dhe Perëndinë tani s'e besoj!

II

Ditën e vititë parë³⁾
 u bë kiamet i madh:
 nga dëbora që ka rarë
 faqez e dheut u sbardh.
 Cingërim' e errësirë,
 jashtë veriu pëllet!
 Bie bor' e breshërirë,
 dheu duketë si det!

3) Ditën e vitit të ri.

Është natë, nat' e zisë,
 vetëtin edhe gjëmon!
 Një ëngjëll i Perëndisë
 dergjet sëmur' e rënkon!
 Ka tri dit' që po mundonet
 dhe me vdekijnë qërton, ⁴⁾
 po vdekja s'do të mërgonet
 se shpirtin e saj kërkon!
 «Perëndi, lemë të gjallë, —
 po lutetë mëm' e mjerë, —
 të mund të rrit këtë djalë,
 s'ka një javë që ka lerë.
 Kush do ta marrë ta rrijë? ⁵⁾
 Jetimi qysh do të rrojë?
 Kush do ti japë të pijë,
 si unë kush do ta dojë?
 Më ndje, o Zot i vërtetë!
 Se Stefani ka babanë
 dhe do ta rritijë vetë.»
 Ëngjëli me këto fjalë
 nga jet' e rreme shpëtoi,
 la baban' e zi me djalë
 dhe ndë Qiell fluturoi!

III

Botë, moj bot' e pabesë,
 nukë ke gjë të vërtetë:
 njeriu po do të vdesë ⁶⁾
 dhe nukë vjen më në jetë.

4) Këtu: hahet, zihet.

5) Ta rritë.

6) Do të vdesë me siguri.

Do të gdhohetë një ditë,
do të vijë një mëngjes,
nukë do të shoh të mitë,
do të mbyll sytë të vdes.

Do të qajn' e të vajtojnë,
do t'më mbulojnë me gurë,
pastaj do të më harrojnë,
dhe sikur s'kam qënë kurrë.

IV

Kur shkoj nëpër varre, ku ka mbirë bari
që rritet e mahet me trupinë tënë,
kujtoj kush ka vdekur, mendoj ç'kanë qënë,
zëmra më lëndonet dhe s'pushon së qari.

Gjithë kanë qënë të gjallë si unë,
të varfër, të pasur, të urt' a të marrë,
mbase kanë dashur, qeshur apo qarë,
po të tërë vdiqnë dhe në varr i vunë!

U lutem, moj eshtra, të kujt ini vallë?
Edhe kurm'i bukur ç'u bë, ku e latë? —
Kujto dialërinë, . . . një ëngjëll, një natë,
t'iku nëpër duar dhe të la me djalë:

ZOLEJKA

Nga gjithë vëndet, Misiri
 ka qën' e është m'i miri:
 gjithëmonë jeshil bari,
 s'ka të sosurë behari,
 Pem' e lule gjithë moti!
 E ka bekuarë Zoti.

Piramidhetë më diell
 kanë kokënë në qiell.
 Buçet Nili nat' e ditë,
 bije ujë të florinjtë.
 Vadit fushënë të tërë,
 nukë ka vënd të mos zërë,
 Ujiten dhe harmadhjetë
 dhe venë, venë përpjetë.
 Veriu s'rreshtetë kurrë ¹⁾
 kur zë e lot me pëlhurë.

Mbanë Nilit punëmbare
 ka qënë Taní më parë,

1) S'pushon.

ka qënë kryeqyteti,
 se këtu kish fronë mbreti.
 Taní ka qënë njëherë
 qytet i madh e i gjerë;
 në mes të këtij qytetit
 ka qënë pallat i mbretit,
 se në këtë qytet rroi
 Apofi kur mbretëroi.
 Pranë mbretit, nga veriu,
 rrinte zoti Petefriu,
 i nderuar në misir,
 se mbreti e kish vezir.
 Mëndjemadh e zemërmirë²⁾
 kishte në dorë Misirë:
 Petefriu mbretëronte,
 se Apofi shum' e donte;
 Apofi me Petefrinë
 bashkë rrinë, han' e pinë.

Petefriu u martua,
 mori Zolejkënë grua. —
 Moj Zolejkë, nga ke dalë
 që ke diellin në ballë?
 Zolejkë, kush të ka bërë,
 që mahnitënë të tërë?
 Të ka bërë Zoti vetë,
 nukë ke shoqe në jetë!
 Kush pa bukurinë tënde
 dhe nukë lojti nga mënde? —

2) I ditur e zemërmirë

Kur do Zolejka të dalë
 me karrocë ja me kalë,³⁾
 vetëm a me Petefrinë,
 hysmeqarkat pas i vinë.
 Kur del Zolejka merr erë,
 dalën dhe shumë të tjerë,
 nukë rri njeri pa dalë,
 kush ta shohë më në ballë!
 Zolejka rri e menduar
 dhe vë kokënë në duar...
 Hysmeqarkat s'guxojnë
 të lözën e të këndojnë.
 Ç'ka Zolejka që s'gëzon?
 Zonjë si ajo kush rron?
 Kush ka të tilla të mira?
 Kush ka gjëra të pavdira?
 Kush ka burrë më të mirë?
 Burr' i saj urdhron Misirë.
 Dashuri, moj dashuri,
 s'peshon ergjënd e flori!
 Sa para bën madhëria?
 Nukë blihet dashuria.
 Duro, Petefri, duro!
 Zolejka nukë të do!

Apofi, mbret' i Misirit,
 i tha një ditë vezirit:
 «Për gjah sivjet s'kemi vatë,
 po të vemi këtë natë,
 se ditën bën shumë vapë;
 në mëngjes kthenemi prapë.»

3) Ose me kalë.

Mbreti këto fjalë foli,
 Petrefriu jashtë doli,
 hysmetçin' e tij kërkoi,
 te Zolejka e dërgoi
 t'i thotë të mos e presë.
 Ne pezul të penxheresë
 rrij Zolejka si ngaherë,
 kur pa Josifnë më derë.
 Nukë qe njëzet vjeç djalë,
 mustaqja s'i kish dhe dalë;
 ish i bukurë si çupë
 dhe për t'u pirë në kupë.

Arapinkatë këndonin,
 Zolejkënë përgëzonin,
 «Zonjë, më dërgoi Zoti,
 Petrefriu fuqiploti,
 këtë natë mos e prini,
 vetëm të hani të pini:
 për gjah sonte do të venë,
 që të dy bashkë me mbrenë.»
 Këto tha djali dhe priti,
 po Zolejka psherëtiti:
 «Pse mban kokënë mënjanë?
 Qasu të rrish këtu pranë,
 dhe Petrefiu me mbrenë
 ku të duan le të venë.
 Ti të rrish sonte me mua!
 Josif, dije që të dua!
 Të dua, të dua shumë!
 Dhe gdhij natënë pa gjumë.
 Që ditënë që të pashë,
 zëmërnë time ta dhashë.

Dale të të puth një herë!
 Këtë natë mos më lerë
 vetëmë me hysmeqarë.
 Josif, bënu djal' i mbarë!
 Eja të rrish këtu pranë,
 kuvëndomë për babanë,
 për mëmën që të ka bërë
 dhe për njerzt' e tu të tërë.
 Pse ke lenë Mëmëdhenë?
 Kush të shiti, ku të gjenë?
 Pse erdhe zure Misirë?
 — Jeshë foshnjë, s'mba mënd mirë.
 Po vëllezrit që kam pasur
 si vëlla s'më kanë dashur,
 dhe më shitnë për të holla.
 — Faqja jote posi molla,
 goja jote si qershia,
 s'të çmohetë bukuria!
 Të dua, Josif, të dua!
 Sonte do të rrish me mua!
 Do të ham' e do të pimë,
 të dy vetëm do të rrimë,
 se është iona kjo natë.
 Zoti e bëftë të gjatë!
 Zogj e bilbilë, këndoni,
 kur të gdhihet të na zgjoni!
 Mos ki turp, mos u bën dialë.⁴⁾
 — Zonjë, zonjë, të jam falë!
 Jam rob' i zotrisë suaj,
 këto fjalë mos m'i thuaj!

4) Këtu: Mos u bëj fëmijë.

Jetim i shkretë, fatziu,
 më ka blerë Petrefiu
 si baba më është sjellë,
 më ka rriturë si pjellë,
 më ka mbajturë me shpresë,
 s'guxoj t'i dal i pabesë!
 — Nga burri im mos ki frikë
 mbaj me vete këtë thikë,
 gjithë trimatë më duan,
 mbreti për mua lë gruan;
 po si ty s'dua të tjerë:
 prapa derësë të fshihesh
 dhe kur të vijë, t'i biesh!
 Vraje Petrefinë vetë!
 Pastaj të më kesh për jetë.
 Josif, Zolejka të do!
 Rri me mua këtë natë.
 Nukë jam si gjithë gratë;
 gjithë trimatë më duan,
 mbreti për mua lë gruan;
 po si ty s'dua të tjerë:
 lemë të të puth një herë!
 Edhe e puthi sa deshi.
 Josifi u ngre nga sheshi,
 i mieri kërkon të dalë.
 Zolejka ju ngjit si ngjalë,
 u zëmërua sa qau!
 Dhe zu Josifnë nga krahu!
 Ky e shtyti me të fortë
 dhe doli jashtë më portë.
 Zolejka mbet turbëruar
 me sakon e ti në duar. 5)

5) Zhaqetën.

(Josifi, që ta lëshojë,
qiti sakon të shpëtojë.)

Dita s'qe dhe gdhirë mirë,
Zolejka, si egërsirë
nga inati që kish marrë,
priti burrën duke qarë!
«Ç'ke që qan, o shpirt?» — i thotë.
dhe vate t'i fshijë lotë.
Po Zolejka qan më shumë.
«Ku më le vetëm, o lumë?
Ike më le me të tjerë...
Josifi më prishi nderë!
Erdhi natën të më zërë
dhe ra me mua të flërë!
Do të më kish turpëruar
sikur të mos jeshë zgjuar,
të mos keshë këtë thikë!
Kur e pa, i erdhi frikë
dhe hapi derën e shkoi.
po sakon këtu harroi!»
Kur dëgjoi Petrefiu
gjithë këto fjalë, ngriu;
kur pa dhe sakon e tija,
i erdhi rrotull shtëpia.
«Zolejkën të turpërojë
Josifi?... Tani të shojë!...»⁶⁾
Dhe urdhëroi ta zënë,
brënda në budrum ta vënë.

3) Te shohë.

KOPSHTI I DASHURISË

O pëllumb' i shkruar,
do t'të marr në duar
dhe duke kënduar
gjetkë do t'të shpie:

në një vënd t'uruar
dhe të lulëzuar,
në uj' të kulluar
edhe nënë hie;

afër tek një lumë
ku ka lule shumë,
të biem në gjumë,
hëna të na ndrijë;

yjtë të shikojnë,
zogjtë të këndojnë
edhe të na zgjojnë
dita kur të vijë.

Pa ngrën' e pa pirë
s'mbetemi, moj Mirë,

se u' ndaj të gdhirë
dërgoj e na sjellin:

qumështë të dhirë
dhe djathë të mirë
pa uj' e pa hirrë,
dhe rrush kur të vjelin;

ngjalë nga Janina,
mjaltë nga Kanina,
verë nga Voshtina,
ujë nga Sopot;

mollë nga Horia,
mish nga dhënt' e mia,
desh nga Labëria, —
na e faltë Zoti!

FYELL' I BARIUT

Bariu, shokë, bariu,
kur gjëmon e fryn veriu
është përjashta fatziu,
e rreh breshëri dhe shiu!
Barinë, shokë, barinë,
mos e harroni të zinë,
se lë gruan e shtëpinë
t'u kullosë bagëtinë.
Kulloni, moj bagëti, 1)
ti, ti, ti...
Kulloni, biro, kulloni,
kur të vdes të më kujtoni,
ndjesë pastë të më thoni.

Shikoni barin' e gjorë:
në diell a në dëborë,
bariu me shkop në dorë
ruan deshtë me këmborë.
Vështroje barinë mirë,
me të ngrën' e me të pirë,
t'u marrë dhëntë va gdhirë,
t'i kullosë me dëshirë,

1) Kullosni.

të rrijë bashkë me to,
to, to, to...
Hani, moj bagëti, hani,
kur të vdes do të më qani,
për mua zi do të mbani!

DËSHIRË

I

Kush lë mikenë që ka
 edhe ndahetë nga shokë
 për të fituar para,
 nuk i ka mëntë në kokë.
 Ikëni, more të mjerë,
 ikni deti tek t'u nxjerë,
 se për mua dashuria,
 ara, vështi dhe shtëpia
 më bëjnë të rroj me gas,
 se s'dua të lë gjë pas.
 S'dua t'iki si përpara,
 dua të rroj nëpër ara,
 mikja pranë të më ketë,
 të punoj aratë vetë.
 Fatmirosh! mot e nga mot
 grur' e misër të kem plot:
 të kem raki, të kem verë
 të ëmbëlë si shilqerë.
 Të vete me bagëti,
 me qe, me dhën e me dhi,
 dhe t'i shpie rëzë malit,
 të hanë majën e barit;

dhe kur të pjellë një dhi,
 do t'i vë kecnë në gji.
 Nuk iki nga Shqipëria
 si punojn' ata që s'dinë;
 mos e dhëntë Perëndia
 të ndahem me dashurinë;
 sa të mund të rroj më pak,
 po këtu të bënem plak.
 Dhe në vuaj, le të vuaj,
 të mos vdes në vënd të huaj!
 Të shoh mëmën e babanë,
 të kem dhe motratë pranë,
 dhe kur të vdes të më qanë
 pas zakoneve që kanë:
 të më marrënë në duar
 të qajnë me lesh lëshuar;
 dhe mikia kur të vijë,
 të qaj' e të ulërijë!

II

Ku janë vaftet e parë?
 Stërgjyshrët sa mirë qenë!
 Shkonin jetënë pa ndarë
 edhe dojnin Mëmëdhenë.
 S'kish pampor e s'kish gjemi,
 nukë vinin të fitonin,
 Atdhenë s'e lij njeri,
 po punonin edhe shkonin.
 Kau nukë kishte zgjedhë,
 as fre për kalën e fortë,
 dhe si s'kish njeri të vjedhë,
 shtëpitë qenë pa portë.

Aratë s'kishnë sinuar,
s'kish të pasur e të varfër,
dheu qe i lulëzuar,
kafsh' e njerz rronin të afër.
Nukë kishte njerz të liq,
se lufta s'kishe dhe dalë,
gjithë bota qenë miq
qenë vëllezër në ballë.
Po tani, Zot i vërtetë,
njeriu ngjan me arinë!
Nukë hiqetë kjo jetë,
se njeriu ha njerinë!
Sot s'mbretëron dashuria,
nukë kemi dashuri;
s'na mbeti as trimëria,
sot rrojmë në robëri!

III

Sot e tutje në shtëpi,
mikia të mbretërojë;
cilido nga miqt e mi
për zonjë duhet ta njojë. ¹⁾
Kur të vete nëpër ara,
kur të korr e kur të mbjell,
të kem mikenë përpara,
kur të shij e kur të vjel.
Dhe në stan kur të më shojë, ²⁾

1) Ta njohë.

2) Të më shohë.

me qe, me dhën e me dhi,
 mikia t'i numërojë
 se mos m'i vjedhë njeri.
 Të më zbukurojë stanë,
 të bëjë djathë të butë,
 t'u hedhë qënet të hanë,
 të na ruajn' nga hajdutë
 Edhe nata kur të vijë,
 të marr mikenë në gji,
 dhe hënëza të na ndrijë
 dhe të na ketë zili.

IV

O shokë, ç'u prish dynjaja.
 si për burra dhe për gra:
 tani shitetë sevdaja,
 mjer ai që s'ka para.
 I pasur të palltë varri!
 Ti që bleve dashurinë
 dhe nuk e le si më pari,
 të marrtë djalli shpirtinë!
 Dëgjoni, more të ri,
 dëgjoni dhe ju të ra:
 duani atë që di,
 jo atë që ka para.
 Duani dhe vjershëtorë
 barabar me Perëndinë,
 se rri me lule në dorë
 edhe këndon dashurinë.
 Ata që janë lëvduar
 me këngë nga vjershëtori,
 janë burra të dëgjuar

dhe rrojënë sa Tomorri.
 O ju të ra e të ri,
 u lutem të më këndon,
 që të kini dashuri,
 kur të vdes të më kujtoni.

V

Moj mike, kam bërë be
 të marr syt' e mi të shkoj,
 se me nazetë që ke,
 me ty nukë mund të rroj!
 Nukë të bëra faj kurrë,
 gjë të ligë s'të kam bërë,
 dhe kur jeshe e sëmure,
 s'më zinte gjumi të flërë.
 Luteshe te Perëndia
 me metani dit' e natë,
 të t'apë nga dit' e mia,
 të kesh jetënë të gjatë.
 Qysh të bëj, more të mjerë!
 Që ditënë q'u shërua
 mikja zuri miq të tjerë
 edhe lot e qesh me mua!
 Një dit' iku e më la,
 se do një që ka para. —
 Nalet paç, moj dashuri,³⁾
 se më trete si qiri!
 Dua të dehem me verë,
 të mund të harroj qederë⁴⁾

3) Lanet paç.

4) Dëshpërimin.

dhe të zë mike të ra,
 të më lënë si më la.
 Po as vera s'më zë kurrë
 as me mike s'bënem burrë.
 Dhe më thonë me mëri:
 «Të kanë bërë magji!»
 S'më zënë magjitë mua,
 po kujtoj atë që dua.

VI

Mike, pse më prish fiqirë?
 Vetë vije më kërkoje.
 Tani ku gjete më mirë?
 Pse s'më thoshe kur s'më doje?
 Më thua që më do shumë,
 po janë fjalë të rreme:
 ikën e më le në gjumë
 edhe më punon llagëme!⁵⁾
 Gjithënjë më turpëron
 dhe më përvëlton si zjarr,
 dhe të ligat që punon
 guxon e m'i zë niqar!⁶⁾
 Mjer' ai që të ka grua,
 nalet pastë kush ta dha!
 Se do ta gënjesh si mua,
 me tertipe të mbëdha.⁷⁾
 Mos e besoni ç'u thotë,

5) Fëlliqësira.

6) Këtu: m'i hedh mua

7) Me sjellje.

gruaja nukë ka besë,
dashurin' e ka të kotë
që kur len e sa të vdesë!
Kush nuk është i zoti vetë
të rojë gruan që merr, 8)
kurrë grua të mos ketë
në do të rrojë me nder.
Qërto, thirrë sa të duash,
gruaja s'e prish qederë,
sa më shumë do ta ruash,
aqë shumë do të tjerë.
Këto bënenë në botë:
burrat që rrojnë nga gratë,
se nuk janë të zotë,
turpëronen dit' e natë...
Të pyetni dhe të tjerë
po të mos besoni mua:
shihni Adhamutn' e mjerë
se ç'heq fatziu me grua!
Sos qirinë do t'i mbajë,
sos të shara të durojë,
se s'ka i gjori të hajë,
s'është i zoti të punojë!

VII

Moj mike, kush të gënjeu
dhe të shiti a të bleu?

8) Të ruaj.

Ai që të gjeti burrë
 mos pafte të mirë kurrë!
 Sëmundj'e madhe ta zërë,
 të mos mundij dot të flërë,
 gjithë natën t'ëndërrijë,
 të mos haj' e të mos pijë,
 ujqrit e qëntë ta hanë,
 të shohë lugat babanë!
 Të tilla ka për të vuar
 ai që na ka trazuar.

VIII

Ata që më kanë sharë
 për dashurinë që kam,
 janë gjithë njerz të marrë,
 se i pari nukë jam.
 Kush qesh me hallet e mia,
 qesëndis me dashurinë,
 ta gjejë nga Perëndia.
 Ç'kanë me mua fatzinë?
 Me egërsira të rrojë;
 Tisifoni me Serberë ⁹⁾
 dit' e natë ta mendojë,
 të mos shohë drit' e erë;
 Zot të vdesë nga uria,
 për ujë ta marrë malli,
 t'i zhuritet mushkëria,
 ta pësojë si Tantali! ¹⁰⁾

9) Qënie mitologjike

10) Mbret i Lidisë. Sipas mitologjisë u dënua të vuaj nga etja.

X

Kur të vijë dhe për mua
dit' e fundit, mike, dua
të vdes në duar të tua:
kur të më shikosh të vdekur,
do të qash, se s'je nga hekur,
se s'jemi më për të pjekur!
Kur të më bëjnë varrë,
do të më puthç duke qarë,
se s'jemi më për të parë.
Do të më qash, moj e mjerë,
se s'piqemi tjetër herë!
Do t'më qajnë dhe të tjerë,
se këndova dashurinë,
këndova dhe trimërinë,
Mëmëdhen' e Perëndinë.

XI

Moj mike, të bëj pors¹¹⁾
vetëmë mua të duash;
mos të gënjejë njeri,
po nderinë tënd të ruash.
Merr një plakë nga mëhalla
të të ruajë ngaherë
dhe të të thotë përralla,
me kandile, duke tjerrë.

11) Porosi.

Dhe gjumi kur të të marrë,
 mbaje plakën në shtëpi,
 shuaj llambën edhe zjarrë
 dhe vetëmë bjer' e fli.
 Në mëngjes, duke kërcyer
 të vij vetë të të zgjoj:
 kur të më shohç pa pandyer,
 të më lësh të të pushtoj.

XVII

Gjithë natën e vadesë ¹²⁾
 frynte er' e binte vesë:
 derëziu po të presë
 në pezul të penxheresë.
 Ma bëre me të pabesë,
 dhe kur dha Zoti mëngjesë,
 u sëmurç e doj të vdesë,
 se nukë rroj dot pa shpresë.
 Ç'më duhetë jeta mua
 kur s'më do ajo që dua,
 leshverdha gjerë më thua,
 cicatë posi limua?
 Ç'të këndoj për të më parë?
 Dhëmbëtë margaritarë,
 buza si qershi e kuqe,
 goj' e saj posi burbuqe,
 syzez' e vetullë hollë,
 faqetë si koqe mollë,

12) Këtu: natën, që më pate premtuar të vije.

mes i saj si rreth unaze, —
më lodh e më vret me naze.

XIII.

Të më bën Zoti dhe mua
një profit, një noitua, ¹³⁾
që të dijë mënt e tua:
Vallë më do sa të dua,
se me gojë s'më the kurrë
më do a s'më do për burrë.
I ziu jam i sëmure,
më digjet koka si furrë,
se nga dashuri e shumë
nat' e ditë rri pa gjumë.

XIV

Zëri qan, shpirti rënkon,
zëmëra katran kullon.
Pse, moj mike, më mundon,
pse unj kokënë kur shkon ¹⁴⁾
dhe bën sikur s'më shikon?
O mor i ziu Andon,
pse vajton e pse s'këndoon?
Mikja zënë s'ta dëgjon,
dhe n'e dëgjon, s'të beson:
nga të të besoj' e mjera,
kur dëgjon fjalë të tjera?

13) Parashikonjës.

14) Ul kokën.

KURBETI

Mitrua, kur u martua,
ndënji një muaj me grua!
Erdhi dita për t'u ndarë
dhe u ndanë duke qarë!
Gruaja qënkej me barrë
dhe kur polli, bëri djalë.
Po Mitrua ku ish vallë?
Motëmot që qe larguar,
një kartë s'i kish dërguar!
Ku t'i shkruaj mëm' e mjerë
për djalënë që kish lërë?
Tri vjet, katrë, dhjetë shkuan!
Mitrua harroi gruan!
Ë varfëra se ç'pësoi,
të ritë vetëm e shkoi!
Ç'e deshi të tillë burrë,
që s'e pati pranë kurrë!
Gjithë bota ven' e vinë,
Mitrua harroj shtëpinë!
Nuk e di që ka dhe djalë!
Rron a ka vdekurë vallë?
Këto thosh grua e mjerë,
po burrit i mbajti nderë.
Ë zeza grua se ç'hoqi!
Humbi shpresën tek i shoqi;

kur pa ngrën' e kur pa pirë,
punoj e rriti të birë.
Kurbeti, shokë, kurbeti!
Kush vate e nukë mbeti?
Mitrua zuri Misirë,
po puna s'i vinte mirë.]
Qysh të vejë puna mbarë
për të zestë shqipëtarë?
Shkretojënë Mëmëdhenë,
tek perndon dielli venë!
Ku vini, more të mjerë?
Se sot s'është si njëherë:
qysh vini në vënd të huaj,
kur s'dini as gjuhën tuaj?
Lum kush rron në vënd të ti
me qe, me dhën e me dhi.
Mos u ndani nga shtëpia,
të mos mpshojë Perëndia,
se Perëndia kur mpshon
gjynaqarët i mundon.
Puna nuk ka të sharë,
po punoni vetë nd'arë,
zini çapën e hostenë
dhe parmëndën që çan dhenë.
Nga fëmia mos u ndani,
po punoni që të hani;
grurëtë që bëni vetë,
u arrin për këtë jetë.
Me zakonetë që kini,
kurbenë duhet ta lini:
të ndershëm jini, të zotë,
po nderi sot s'ka shkuar,
e drejta në këtë botë
është fare shtrëmbëruar...

Në kurbet venë të tjerë,
 ata që s'duanë nderë,
 se zakonet u ndërruan:
 burri që fiton, shet gruan,
 burratë rrojnë nga gra!...
 Po për Mitro shqipëtarë
 këto zakone të ra
 nuk i dukeshinë mbarë.
 Ndaj hoqi e voi shumë,
 kur pa buk' e kur pa gjumë:
 rrahu Misirë të tërë,
 nukë la punë pa bërë,
 gjithë jetën nënë urdhër,
 qeseja si kokë hudhër!
 E shoqia e kish qarë,
 njëzet vjet që s'e kish parë!
 Dhe në mos e paftë kurrë,
 djali ju rrit, u bë burrë:
 mëmën do ta mbajë mirë
 me të ngrën' e me të pirë.
 Pas njëzet vjet, nga kursimi,
 Mitros ju shtua fitimi:
 solli ndër mënd Shqipërinë,
 gruan e tij dhe shtëpinë;
 psherëtiti zëmr' e ti
 dhe qau si çilimi;
 dhe nesërmet, ndaj të gdhirë,
 Mitrua e la Misirë.
 Ta kish ditur kur ish ndarë
 që la gruan me barrë,
 mbase kish ikur më parë.
 Shtatë dit' e shtatë net
 bëri Mitrua në det;

mbaroi udhën e gjatë
 dhe vate në fshat me natë.
 Në shtëpi u afrua,
 ndënji pak e u mendua,
 dhe me vete të tij thosh:
 «Në gjeça shtëpinë bosh?
 Në mos e gjeça të gjallë
 gruanë!» Me këto fjalë
 shikon shtëpinë me dritë
 edhe vate në fengjitë ¹⁾
 të shohë kush është brënda:
 (T'i përgjojë ja ka ënda.)
 Djali kuvëndon me mëmë:
 «Pse qan, i thosh, kur ke mua?
 Ç'kanë shkuarë t'i lëmë
 dhe duamë si të dua.
 — Të dua, thosh mëm' e mjerë,
 me shpresë tënde kam rruar, ²⁾
 nga ti harrova qederë
 dhe gjith ato që kam vuar,
 dhe sot rroj me shpresë tënde.»
 Kur gjegji këto kuvënde,
 Mitrua ngriu në fengjitë:
 fatziu, ç'vuri nër mënde!
 Vuri syn' e pa në dritë:
 pa një trim të ri me grua!
 Mëndia ju trumbullua!
 (Mitrua kujton Misirë,
 sheh vetëhenë me brirë!) ..
 O Mitro, mendoju mirë,
 mëma përkëdhel të birë;

1) Në frengji, në dritaren e vogël.

2) Kam rrojtur.

nukë të ka turpëruar,
 se me nder të madh ka rruar!
 (Ç'mendone, more fatzi!)
 Ryrë mbrënda në shtëpi ³⁾
 dhe merr djalënë në gji.
 «Obobo! sytë ç'më panë! —
 tha Mitrua si i marrë. —
 Pashë gruan me jaranë!
 Po tani do t'ju bëj varrë!
 Do t'u bie me kobure,
 t'i lëshoj në shesh shondure. ⁴⁾
 Mua të më vënë brirë!»
 tha, dhe goditi të birë!
 Mëm' e zezë ulëriti,
 pushtoi djalën dhe briti!
 Po Mitrua nukë priti:
 pushka krisi dhe një herë,
 ra përmbys dhe mëm' e mjerë!

3) Hyr.

4) Shakull.

MISIRI

Fushë dhe fushë dhe fushë prapë,
fush' e pasosur dhe shumë vapë.
Mal s'të sheh syri, as breg, as gurë,
po gjithëmonë tym' e pëlhurë.¹⁾
Miza dhe pleshta dhe morra shumë,
kunup'i shkretë të lë pa gjumë.
Era e ngröhtë, ujëtë trumbull;
fiku me gjëmbe, pjepri si kungull.
Përrenj s'ka fare, vetëm një lumë,
i madh si deti, mbulon me shkumë
fushën të tërë, gjithë Misirë.

. : :

Aratë s'reshten, i vadit Nili:
tek korret gruri, mbillet tërfili,
elbi dhe misri, thekra, pambuku,
dhe dëm e kotë s'mundonet bujku
Qetë si buaj, qëni si ujku.
Pyll s'sheh dot kurrë, as re në qiell.
Fshatratë çveshur digjen në diell.

1) Pluhur.

Udhët plot çuna, koshet plot mjaltë,
 shtëpit' kasolle bërë me baltë,
 lyer me bajga brënda dhe jashtë,
 janë mbuluar me dru dhe kashtë.
 Kuaj të mirë dhe të lëvduar,
 gomarë shumë dhe të dëgjuar.

. : :

Behari furrë, dimri si vera,
 bashkë kullosin dhëntë me derra.
 Shumë të pasur e të papunë
 në dimër vinë rrinë këtunë.
 Nëpër qytete, nga minaretë,
 hoxhët pëllasin me zë si qetë.
 Njerz të betonen për Muhamenë
 dhe kur i falen puthinë dhenë.
 Udhëtë shtruar me gurë si shtufë,
 njerzitë venë, vinë si tufë,
 zbathur e çveshur dhe të ngarkuar,
 po parësia m'umbrell në duar,
 dhe grat' e tyre dalën mbuluar,
 Vdes njeri? Gratë zën' e vajtojnë,
 qajn', ulërijnë, sikur këndojnë.
 Këtu ka princë dhe pashallarë,
 bejler' më tepër se nga gomarë;
 të pasur shumë, sa s'dinë ç'kanë,
 po më të shumë të s'kanë të hanë.
 Përmbi të gjithë, një *Efendinë* ²⁾
 qeveris vëndë nënë Anglinë.

2) Zëvendës mbreti (khedivi).

KORRIKU

Na erdhi korriku prapë
me grurë të ri, me vapë.
Mirë q'erdhe, o korrik,
gjithë bota të ka mik.
Të duanë varfëria,
se s'vdes njeri nga uria.
Korriku, si flak' e drizit,¹⁾
na ngron palcën e kurrizit.
O korrik, o faqezjarr,
gjithë lule, gjithë bar,
dhe me pemë barrë-barrë,
s'dimë ç'të hamë më parë.
Në korrik piqen me radhë
pjeshkë, mollë, thanë, dardhë;
kur afëronet korriku,
ze të piqetë dhe fiku.
Nga gjithë pemët e tjera,
fiku na mbiftë te dera,
se gjer sa ka shporta fiq,
gjithë bota janë miq...

Me shpresë të këtij muaj,
punëtor, puno e vuaj.

1) Flakë e drizës.

Të punojmë që të gjithë,
 të mos mbetemi pa drithë,
 se në këtë muaj Zoti
 na kërren nga tërë moti.
 Ata që kanë punuar,
 në korrik janë gëzuar,
 se në këtë deli muaj
 nukë ka lëmë pa duaj.
 Vjen korriku! Punëtorë
 mirri drapërin në dorë,
 të korrë kush ka punuar,
 kush ka mbjell' e ka lëruar.
 Dili, dili nëpër ara
 e shihni ç'ka bërë fara:
 shikoni një koqe gruri
 se sa koqe grurë pruri.
 Shikoni kallijt e verdhë,
 në korrik duanë mbledhë.
 Shihni, shihni kur fryn era,
 kallijtë lozin si shqerra;
 me diell, kur fryn veriu,
 si floriri ndrit kalliu.
 Fusha, ara, palë-palë,
 duken si deti me valë.

Fush' e gjatë, fush' e gjerë,
 pse më bën të qaj ngaherë?
 Me djersën e varfërisë
 gjith' arat e Shqipërisë
 vaditen e gjë s'kërrejne,
 se të huajt' i rrëmbejnë!
 Shqipëtari, dëm e kotë,
 punon gjithënjë për botë:

aratë që mbjell, ngaherë
ven' e i korrin të tjerë!
O korrik, o faqezjarr,
je dukur dhe luftëtar:
ndë Francë (kush nuk e di?)
u ngre vëndi për liri;
në korrik lufta u zu,
u bë gjaku gjer në gju...
Kryeqitjetë q'u bënë, ¹⁾
prej korriku janë zënë;
se zjarrë që ndes korriku
nuk e shuan dot armiku;
se dielli është i ngrohtë,
ndes gjaknë ndë gjithë botë.
Gjaku i trimit vërtetë
për Liri ndizet vetë:
gjaku yt, o shqipëtar,
s'të ndizet as në behar!
Të ndestë vap' e korrikut,
t'i biesh në kok' armikut!

1) Kryengritjet.

FARAONI DHE ARAPËT *)

Kur mbeti vetëm patriku,
gjithë bota ju mërzit,
prandaj nga qyteti iku
edhe doli të shetit.
Ik' e ikë nëpër vapë,
përtejë nga lumi hidhet,
sheh një milion arapë
që po bëjnë piramidhet:
gjithë zbathur e pa brekë,
si janë sot ca dervishë,
buk' e qepë dark' e drekë,
gra e burra pa këmishë.
Oh, të zestë punëtorë!
Duke punuarë, qanin,
se ca me kamzhik në dorë
i qërtonin e i rrahnin,
dhe mos i goditnin pak!
Bobo, arapët e mjerë!
I rrihnin sa u dil gjak
dhe sa vdisnin, ca të tjerë.

*) Vjershat që pasojnë janë nxjerrë nga përmbledhja
«Dhjata e vjetër»

Të tilla kur pa patriku,
mu ndë shpirt u mallëngjye,
mëndj' e kokës desh i iku,
edhe nga frika u kthye.
Pastaj, duke fshirë lotë,
mendonej Abram' i mjerë:
«Sa poshtë që ra kjo botë
dhe sa poshtë do të bjerë!»
Dhe me vetëhe po thosh
për të këqijat që pa:
«O Abraham, rro të rrosh,
të shohç dhe më të mëdha!
Obobo, ç'punëra pashë!
Se si sillet njerëzia!
Robëria na bën kafshë,
na turpëron varfëria!
Moj e shkreta varfëri,
mjera ti për këto gjëra!
Ai që s'ka nukë di
dhe kush ka i di të tëra!
Ai që ka bën si do,
ai që s'ka bën si mund!
Duro, varfëri, duro, —
po dhe durimi ka fund!
Ç'janë këto të këqia,
që punon, o Faraon?
Hiq dorë, se Perëndia
mënon, po nukë harron.
Kur vunë mbret, gabimë bënë
njerëzit, rrojnë pa nder:
na merr gjakn' e na merr gjënë
na merr. . . , pa ç'nukë na merr?

*

Zot i madh e i vërtetë,
ç'të të them as un' s'e di;
shiko, një milionë vetë
punojnë për një njeri!
Për një Faraon të marrë
punojnë burra dhe gra,
dhe i bëjnë duke qarë
piramidhe të mbëdha!
Këta gurë qysh i ngrenë
dhe nga ç'vënd i kanë sjellë?
Dhe një mbi një qysh i venë?
Çdo gur është sa një shpellë.
Për një Faraon të marrë
gjithëkush punon pa shpresë,
se mbreti bën gati varrë,
që ta vënë kur të vdesë.
Këto piramidhe ç'janë?
Ç'punoni, ore të mjerë?
Ububu, sa njerz që vanë,
sa do të vënë të tjerë!
Me pahir asnjë mos rroftë,
se ndë robëri rënkon!
E tillë jetë mos qoftë,
se ai që vdes shpëton!
More arapë të gjorë,
sa të rrojë Faraoni,
do t'u ketë shërbëtorë
dhe për të do të punoni...»

URIA

Uria, qoftë mërguar,
sa të liga ka punuar!
Zoti madh të na shpëtojë,
është m'e rënda nevojë.
Nukë ka m'e ligë, nukë:
është keq të mos kesh bukë.
Uria burrat e gjorë
i bën rob e shërbëtorë.
Nukë numëronen gratë,
që shiten për një kafshatë.
Cili njeri mund të shajë
një grua që s'ka të hajë
dhe shet nderë që të rrojë?
Cili guxon të gjykojë
me të drejtë dhe pa dhunë
një njeri që s'gjen dot punë
dhe që vjedh ata që kanë,
t'u apij djemet të hanë?
Njerzt e pasur, zëmërgurtë,
s'i besojnë njerzt e urtë¹⁾
dhe nuk u ndihmojnë kurrë,
s'u falin asnjë grusht grurë.
Këta pse qënkan fajtorë,
kur marrin vetë me dorë?
Si duani, nga uria
të vdesin vet' e fëmia?

1) Të uritur.

SULLTANI

Sulltani, si egërsirë,
s'le gjë të ligë pa bërë:
prishi gjithë njerzt e mirë
dhe la të liqtë të tërë.
Na mori dreqi na mori,
me këtë sulltan të marrë:
u mbush i tërë Bosfori
me njerz të mbytur, të vvarë.
O Stamboll me Bri të Artë,
të rënt' e të djegtë zjarri!
Të marrtë djalli, të marrtë,
të shpëtojmë nga i marri!
Stamboll, qytet i vështirë,
të shkretoftë Perëndia,
se qëntë rrojnë më mirë,
më mirë se njerëzia!
Egërsirë si ariu,
me një gojë si një furrë,
sulltani ha mish njeriu
dhe nukë ngopetë kurrë.
Sulltan, mbret sikur të jeshë,¹⁾
do dijë të mbretërojë:

1) Sikur të isha.

gjithë njerzit do t'i keshë
si djemt e mi, do t'i dojë.
Do t'i ndijë varfërisë
dhe do të nderojë pleqtë;
ndë shërbim të mbretërisë
do të vërë njerz të drejtë.
Të liqtë do t'i mendojë,
do t'i lërë lark të venë;
me besë do të punojë
për kombin dhe për Atdhenë.
Luftën, që prish njerëzinë,
nukë do ta dojë kurrë,
po, në më shkelnin kufinë,
do të luftojë si burrë!
Për dritën e diturisë
do të përpiqesh me besë,
edhe mbrojtës i lirisë
do të jeshë sa të vdesë!

LABËRISË

O Labëri, sa të dua,
pyjet e kodrat e tua,
ato gryka, ato male,
ku dhe zogu shkon ngadale;
shkëmbenj dhe shpella si thikë,
që t'i shikojsh të vjen frikë,
Gryk' e Kuçit, kush ka shkuar
dhe gjaku s'i ka qëndruar?
Udhëtari nga të vejë,
mal këtejë, mal andejë;
ndë mes, një lum i habitur,
vërtitet, duke buçitur.
Lisa të gjer' e të gjatë,
e bëjnë ditënë natë.
Anës lumit, ndënë hije,
çfaqetë një rrugë dhije,
rrug' e ngushtë nëpër gjëmbe,
mjerë kujt t'i shkasë këmba.

Ndë këtë grykë të shkretë,
u vranë dy mijë vetë;

dy mij' ushtarë ç'u ngrinë
të shkelmojnë Labërinë,
po Gjon Lekën nuk e dinë,
q'i pret ndë grykë të vinë.
— O burra, o shqipëtarë! —
thirri Gjon Leka më parë. —
Turku kërkon të na marrë,
po këtu t'u bëjmë varrë!
Kush është trim edhe burrë,
tani duhet, në mos, kurrë!
Te gryka që do të zemë,
turk të gjallë të mos lemë,
dhe në mos kini fishekë, —
po bërtet trimi Gjon Lekë, —
bini armikut me gurë,
ta bëni balt' e pëlhurë!»
Kur dëgjuan këto fjalë,
nukë mbeti lab pa dalë:
treqind lebrë qimeverdhë
te Gryk' e Kuçit u derdhë,
Kryetar Gjon Lekë trimi.
Shokë, sa ç'punon bashkimi:
tre-katër qind shqipëtarë
dërrmuan dy mij' ushtarë!
Nukë mbeti turk ndë këmbë,
kafshuan dhenë me dhëmbë.
Dhe pak të gjallë që mbenë,
nukë dinë nga të venë.
Thotë fjala dhe kuvëndi;
trimin e mir' e bën vëndi.
Kuçi ndë mes të rrëkeve,
të lumtë se ç'trim kërreve!
Të lumtë për trim që nxore,
s'të çmonet nderi që more!

Malet e Kuçit u nxinë,
s'mbin as bar, as trëndelinë,
për Gjon Lekën mbajnë zinë,
që nderoi Labërinë.

U trete, Gjon Lek', u trete!

Sos u përpoqe për vete,
ngrite luftë me Turqinë
për të tërë Labërinë.

Po Labëria ka nxjerrë
dhe shumë trima të tjerë:

Ali pashai nga doli,
që mori frikë Stambolli?

Birbilenjtë dymbëdhjetë,

burra trima të vërtetë,

Rrapo Hekali me vulë,

Hamit Guga me Resulë,

gjithë këta dhe të tjerë

ndë Labëri kanë lerë.

Shqipëri, Shqipëri lule,

ke hije të jesh fodulle.

Ç'vënd i egër a i butë

kërren trima si të tutë?

MALLI I SHQIPËRISË

Vanë mënt e mija, vanë,
ndë Shqipëri tek kam lerë,
ku kam nënën e babanë,
kushërij e njerz të tjerë;
ku pashë dritën e parë,
ku kam miq, shokë të gjallë,
tek dëshiroj të kem varrë,
shpirti kur do të më dalë.
Obobo, sytë ç'më panë!
Shkretëtirë, lum e det!
Këtu gratë vetëm janë,
burrat gjënden në kurbet.
Shikoj pas, shikoj përpara,
duke ecur me ngadale,
gra punojnë nëpër ara,
nëpër fusha, nëpër male.
Me ca petka vëra-vëra,
u çuditçë kur i pashë;
me kokë poshtë të tëra, —
ç'janë këto kafshë? — thashë.
Punoni, moj gra, punoni,
dhe duke punuar, qani;
të tërë jetën mundoni ¹⁾
dhe bukë s'kini të hani!

1) Mundoheni.

Nga gulçimi buçet era,
 se rënkojn' e qajnë gratë;
 çlodhuni pak, moj të mjera,
 se punoni dit' e natë!
 Burrat vetëm u lanë
 dhe rripen ndë dhe të huaj;
 ata më keq nga ju janë,
 se ju rroni ndë vënd tuaj.
 Atdhe me male të naltë,
 ti që më rrite që djalë,
 dërgomë një grusht me baltë,
 ta puth, të të kërrej mallë!
 Ndë dhe të huaj, besomë,
 zëmëra m'u mallëngjye;
 dërgomë një gur, dërgomë,
 ta vë jastek ndënë krye!
 Mëmëdhe, që më dhe sisë,
 bën një punë më të mirë:
 thyej zgjedhën e Turqisë,
 të vij të të shoh të lirë!
 Të mos heq e të mos vuaj
 posht' e lart e i sëmurë,
 të mos vdes ndë dhe të huaj,
 se nuk do të tretëm kurrë!
 Ç'do turku ndë shtëpi tënë?
 Nuk është e jona kjo tokë?
 Në do të jesh si ç'ke qënë,
 bjeri armikut ndë kokë!
 Ngreu, moj Shqipëri, ngreu,
 vish armët e trimërisë!
 Turqia sado të shqeu, 2)
 bjeri ndë kokë Turqisë!

2) Mjaftë të shqeu.

GËNJESHTRA

Njeriut fundi s'i dihet,
sot erret e nesër s'gdhiet.
Botë, moj bot' e pabesë,
nukë ke gjë të vërtetë,
se çdo njeri do të vdesë
dhe s'vjen dot prapë ndë jetë!
Do të gdhietë një ditë,
dit' e zezë, dit' e ndytë,
nukë do të shoh të mitë,
do të vdes e të mbyll sytë!
Do të qajn' e të vajtojnë,
do t'më mbulojnë me gurë,
pastaj do të më harrojnë,
dhe sikur s'kam qënë kurrë!
Lum ata që kanë besë
për një jetë më të mirë!
Lum ai që do të vdesë
me këtë shpres' e dëshirë!
Po ndë varre, kur shoh eshtra,
që mbajnë dhe bijen erë,
them: këto janë gënjeshttra,
kush vdes s'ngjallet tjetër herë!
Ç'jetë tjetër do të presëm,
si besojn' ata që s'dinë?
Është nevojë të vdesëm,
pra të shohmë Perëndinë?

Me sy hapët e i gjallë,
sa gjendem ndë këtë jetë,
pse nuk e shoh kurrë, vallë,
ta besoj me të vërtetë?
Duhetë që të mbyll sytë,
pra ta shoh? Qeshni me mua:
n'është e tillë jet' e dytë,
të tillë jetë s'e dua!...

RAKILA DHE JAKOBI

Baresha humbi barinë
dhe pyet shoqet e tjera:
— Mos më patë dashurinë
ndë këto kodra të gjera?
Është trim me të vërtetë,
ka një bukuri të rrallë,
e zgjodha ndë një qind vetë,
Perëndia ma ka falë.
Moj shoqe, mos më mundoni,
u lutem, për Perëndinë,
n'e patë, të më dëftoni,
të vete të gjej barinë.
Doli nga stani një natë.
ka një javë që si sot
nuk e di se ku ka vatë,
e kërktoj e s'e gjej dot!
Kushdo që të ma tregojë,
do t'i fal një palë vathë,
gjalpë e kos sa të dojë,
dhe dhjetë napë me djathë.
— Nukë duket në fshat tënë,
dil e këndo nëpër ara;
kur të të dëgjojë zënë,
do të të dalë përpara.

— Ju lule, që lulëzoni,
dhe ju zogi, që fluturoni,
o ju, shelegët e stanit,
dhe ju çupat e Karanit,

u faltë Zoti gëzime,
mos ma patë miken time?
Një syzez' e gushëbardhë,
me dy sisë si dy dardhë,
një leshgjatë, një mes' hollë,
me dy faqe si dy mollë,
një shtatderdhur si selvia,
me një gojë si qershia,
ecën fort e shkel ngadale,
mos e patë nd'ato male?
Mos e patë nd'ato kodra?
U lutem me lot, moj motra,
rrëfeni, paçi uratë,
mos e poqtë, mos e patë?
Që ditën që s'e kam pranë,
vanë mënt e mia vanë!
Ika, lashë vetëm stanë,
kërkoj miken në çdo anë;
e kërkoj, po s'e gjej dot,
nat' e ditë qaj me lot,
mbusha mandilenë plot!
Shokë, jeta m'u rëndua,
se s'gjej dot atë që dua.
Është ëngjëll, nuk është grua,
është yll e është hënë,
është mollë për të ngrënë,
që s'ka shoqe ndë vënd tënë.
Shokë, kush të ma tregojë,
do t'i fal çdo që të dojë,
dhe shpirtin të më kërkojë!
Do t'i fal shqerra të pirë,
deshtë që kam më të mirë,
gjalpë, djathë, gjiz' e hirrë,

PASQYRA E LËNDËS

| | |
|---------------------------|----|
| Parathënie | 3 |
| Mëmédheu | 7 |
| Shqipëtarë! | 8 |
| Sulltani | 11 |
| Punërat e perëndisë | 14 |
| Atdheu dhe dashuria | 16 |
| Fshati im | 21 |
| Dashuria | 23 |
| Vaje | 30 |
| Zolejka | 34 |
| Kopshti i dashurisë | 41 |
| Fyell'i bariut | 43 |
| Dëshirë | 45 |
| Kurbeti | 56 |
| Misiri | 61 |
| Korriku | 63 |
| Faraoni dhe arapët | 66 |
| Uria | 69 |
| Sulltani | 70 |
| Labërisë | 72 |
| Malli i Shqipërisë | 75 |
| Gënjeshtër | 77 |
| Rakila dhe Jakobi | 79 |